



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 187/23

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datum 27.07.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 shkronja “d” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, si dhe duke marr për bazë kërkesën e MAPL-së të datës 03.07.2023 për rishqyrtimin e aktit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë (Rregulloren për punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë), Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27 korrik 2023**, merr këtë:

### VENDIM

1. Me këtë vendim rishqyrtohet Rregullorja (KKV) Nr.04/2023 për Punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë e miratuar me datën 31.05.2023.
2. Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë duke ju përgjigjur kërkesës së MAPL-së për rishqyrtimin e aktit të cekur më lartë vendosi që pika e 4 e nenit 4 të mos hiqet nga rregullorja për Punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, me arsyetimin se puna e komiteteve dhe komisioneve është rregulluar me Rregulloren e Punës së Kuvendit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet kryesuesja e kuvendit të Komunës së Vushtrrisë dhe Sekretaria e Kuvendit.
4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

### Arsyetim

Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 27 korrik 2023, ka rishqyrtuar Rregulloren (KKV) Nr.04/2023 për Punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë e miratuar me datën 31.05.2023 sipas kërkesës për rishqyrtim të aktit të komunës të datën 03.07.2023 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në ç’ rast kuvendit pas votimit me 11 vota “për”, 13 vota “kundër” dhe 2 vota “abstenim” vendosi që pika e 4 e nenit 4 të rregullores që është objekt rishqyrtim të mos hiqet nga rregullorja, me arsyetimin se puna e komiteteve dhe komisioneve është rregulluar me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

*Në rastin konkret konsiderohet se rregulloja nuk prodhon ndonjë efekt juridik, pasi e njëjta nuk ka hyrë në fuqi.*

**Melihate Basholli-Latifi**

**Kryesuese e Kuvendit**





REPubliKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRRI
01 Nr. / Br <u>130/23</u>
Nr. / Tq. / Nr. sh <u>-9-</u>
Data: / Datum <u>31.05.2023</u>
VUSHTRRI - VUÇITRRI



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI**

**RREGULLORE**  
**(KKV) NR.04/2023 PËR PUNËN E KOMITETEVE DHE KOMISIONEVE**  
**TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË**

**Maj, 2023**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja “c” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Udhëzimin Administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, nenit 19, pika 1.3 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **31 maj 2023** aprovon këtë:

**RREGULLORE  
PËR PUNËN E KOMITETEVE DHE KOMISIONEVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS  
SË VUSHTRRISË**

**I. DISPOZITA E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Me këtë rregullore përcaktohen, numri, përbërja kompetencat, aktivitetet, mënyra e punës së komiteteve dhe komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokal, Udhëzimet Administrative që rregullojnë këtë fushë, si dhe Statutit të Komunës.

**Neni 2**

**Përkufizimet**

1. Çdo herë kur në këtë Rregullore përdoren, termat vijuese kanë kuptimin e përcaktuar më poshtë, përveç rasteve kur konteksti ku paraqitet termi i tillë tregon qartë se ka kuptim tjetër:

1.1. “Ligj” nënkupton Ligjin për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 të datës 20.02.2008

1.2. “Statut” nënkupton Statutin e Komunës së Vushtrrisë

1.3. “Kuvendi i Komunës”, nënkupton Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë,

1.4. Anëtari i komitetit/komisionit nënkupton anëtarin e emëruar nga kuvendit i komunës;

1.5. “Komitet”, nënkupton Komitetet e formuara nga Kuvendi i Komunës.

1.6. “Shërbimi Profesional për Punët e Kuvendit”, nënkupton shërbimin përkatës që ofron shërbime profesionale, juridike dhe teknike për komitetet e Kuvendit të Komunës. (Sekretaria e Kuvendit).

1.7. Kryesuesi i komitetit/komisionit nënkupton kryesuesin e emëruar nga komiteti/komisioni.

## II. PËRBËRJA, KOMPETENCAT DHE AKTIVITETET E KOMITETEVE

### Neni 3

#### Nocioni i Komiteteve

1. Komitetet janë trupa ndihmës të Kuvendit të Komunës dhe punojnë për dhe në emër të Kuvendit të Komunës. Roli i tyre është që të lehtësojnë punën e Kuvendit të Komunës në lidhje me procesin e marrjes së vendimeve, që lidhen me çështje të caktuara, duke trajtuar, hartuar, propozuar çështje me interes të përgjithshëm dhe në këtë mënyrë do të plotësohet një vakuum i cili i ka munguar aktivizmit Kuvendar.

2. Shumë çështje jetike të cilat presin zgjidhje dhe ballafaqohet komuna në të shumtën e rasteve i takojnë natyrës teknike që kërkojnë angazhimin e ekspertëve që janë anëtar të Kuvendit, por që shërbejnë si anëtarë të Komiteteve relevante. Prandaj, komitetet kanë rolin që të ndihmojnë Kuvendin në kursimin e kohës dhe përpjekjeve duke i ofruar Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit ekspertizën politike, juridike, financiare, teknike, rekomandime, konsultime dhe angazhim në çështje specifike.

3. Komitete tjera të kuvendit gjatë aktivitetit të tyre do të mbajnë, 6 mbledhje në vit.

4. Shumica e anëtarëve të Komiteteve, (pos Komiteteve Konsultative) do të jenë anëtar të Kuvendit të Komunës. Anëtarët e Komiteteve do të reflektojnë sa më shumë që është e mundur me proporcionin e vendeve që kanë partitë politike në Kuvendin e Komunës.

### Neni 4

#### Kompetencat e përgjithshme dhe rolet e Komiteteve

1. Komitetet mund të propozojnë prioritetet e buxhetit Brenda një fushe të caktuar në mënyrë që të drejtohen në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe pasi të rekomandohen nga Komiteti për Politikë dhe Financa të dërgohen për aprovim në Kuvendin Komunal.

2. Komitetet do të shqyrtojnë në vazhdimësi aktivitetet dhe zbatimin e rregulloreve tek drejtoritë përkatëse (planet e punës, raportet mujore dhe vjetore, informatat, raportet mbi vlerësimin etj.) si dhe formimin e propozimeve hartimin e propozimeve për Kryetarin e Komunës me çka do të ndihmohet përmirësimi i kryerjes së punëve nga drejtoritë.

3. Komitetet do të rekomandojnë në përgatitjen dhe hartimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës që i referohen një fushe të caktuar të aktiviteteve brenda përgjegjësiive të Komitetit.

4. Të gjithë anëtarët e komiteteve konform dispozitave të statutit të komunës, do të marrin kompensim financiar për pjesëmarrje në punën e komiteteve komunale. Kryesuesi i komitetit do të jetë përgjegjës për koordinimin e punës së komitetit komunal si dhe të përgatis orarin e mbledhjeve ad-hoc, të udhëheq listën e pjesëmarrësve, të sigurojë procedurat e kompensimit të anëtarëve të komitetit, informatat mbi vlerësimin individual të kryerjes së punëve nga anëtarët dhe të paraqes raport për punën e komitetit së paku një herë në vit.

5. Administrata komunale ( sekretaria e kuvendit) do të ofrojë mbështetje të nevojshme logjistike dhe administrative për kryerjen e punëve me sukses të komiteteve duke përfshirë shpërndarjen e materialeve për mbledhje sipas nevojës, vendtakimet, procesmbajtësin, vendosjen në dosje të procesverbaleve dhe materialet e tjera të komiteteve.

#### **Neni 5 Formimi i komiteteve**

1. Konform dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë formohen dy komitete të përhershme;

1.1. Komiteti për Politikë dhe Financa, dhe

1.2. Komiteti për Komunitete.

2. Konform dispozitave të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës formon komitete tjera:

2.1. Komiteti për Buxhet dhe Financa

2.2. Komiteti për Arsim dhe Kulturë

2.3. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

2.4. Komiteti për Planifikim Urban, Mbrojtje të ambientit, shërbime publike dhe emergjenca

2.5. Komiteti për Zhvillim ekonomik, bujqësi dhe zhvillim rural

2.6. Komiteti për barazi gjinore, të drejta të njeriut dhe komunitete.

#### **Neni 6 Komiteti për Politikë dhe Financa**

1. Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet prej nëntë (9) anëtarëve.
2. Të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të zgjedhen nga radha e anëtarëve të Kuvendit të komunës.
3. Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteteve politike në Kuvendin e komunës.
4. Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal, marrjen e raporteve nga Kryetari, si dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e komunës.

5. Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të reflektojë përfaqësimin gjinor.
6. Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa nuk kanë të drejtë të jenë edhe anëtarë të komiteve tjera
7. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa thirren dhe kryesohen nga Kryesuesi/ja i/e Kuvendit të komunës. Në mungesë të Kryesuesit/es të Kuvendit të komunës, mbledhja kryesohet nga anëtari/ja më i/e vjetër i/e komitetit.
8. Ftesa për mbledhje duhet t'u dërgohet anëtarëve shtatë ditë pune para mbajtjes së mbledhjes.
9. Për secilën mbledhje komiteti mban procesverbal dhe të njëjtin e aprovon komiteti në mbledhjen e radhës.

### Neni 7 Komiteti për Komunitete

1. Komiteti për Komunitete mund t'i ketë nëntë (9) anëtarë.
2. Anëtarët e Komitetit për Komunitete, zgjedhen nga Kuvendi i komunës nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të komunës dhe përfaqësuesve të komuniteteve pakicë.
3. Komunitetet pakicë në komunë, duhet të kenë përfaqësimin e paraparë me ligjin në fuqi në Komitetin për Komunitete.
4. Përbërja e Komitetit për Komunitete duhet të reflektojë përfaqësimin gjinor.
5. Komiteti për Komunitete përfshin në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e Kuvendit të komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në komunë, përfaqësohet nga së paku një (1) përfaqësues në Komitetin për Komunitete. Përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë në komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të Komitetit të Komuniteteve.
6. Komiteti i Komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të komunës masat që duhet të ndërmerren për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.
7. Ftesa për mbledhje duhet t'u dërgohet anëtarëve shtatë ditë pune para mbajtjes së mbledhjes.

8. Për secilën mbledhje komiteti mban procesverbal dhe të njëjtin e aprovon komiteti në mbledhjen e radhës.

#### **Neni 8**

#### **Komiteti për Buxhet dhe Financa**

1. Komiteti për Buxhet dhe Financa përbëhet nga 5 anëtarë që duhet të reflektoj në kuotën gjinore.

1.1. Kompetencat e këtij Komiteti janë:

1.1.1 Shqyrton projekt - buxhetin e komunës,

1.1.2. Shqyrton të gjitha politikat dhe dokumentet fiskale të komunës,

1.1.3. Përgatitë draft-rregullore, propozim-vendime dhe dokumente tjera të nevojshme lidhur me zbatimin e politikave të ndryshme fiskale dhe në interes të përgjithshëm, të njëjtat procedohen në Komitetin për Politikë dhe Financa.

1.1.4. Shqyrton raportet mbi të hyrat dhe shpenzimet komunale dhe të gjitha raportet tjera që lidhen me çështjet financiare;

1.1.5. Shqyrton Kornizën Afatmesme Buxhetore, të njëjtën e rekomandon për shqyrtim në KPF dhe kuvend të komunës;

1.1.6. Shqyrton dhe jep rekomandime gjatë fazës së hartimit të strategjisë për zhvillimin ekonomik të komunës;

1.1.7. Shqyrton dhe jep rekomandime për adresimin e nevojave gjatë fazës së rishikimit dhe hartimit të buxhetit të komunës;

1.1.8. Shqyrton dhe jep mendime profesionale lidhur me orientimin e investimeve kapitale gjatë planifikimit të buxhetit vjetor të komunës;

#### **Neni 9**

#### **Komiteti për Arsim dhe Kulturë**

1. Komiteti për Arsim dhe Kulturë përbëhet nga 5 anëtarë që duhet të reflektoj në kuotën gjinore.

1.1. Kompetencat e këtij Komiteti janë:

1.1.1 Të shqyrtojë rregullat për arsim dhe kulturë,

1.1.2. Të këshilloj dhe konsultohet me Drejtoritë Respektive,

1.1.3. Të përgatis draft-rregullore, propozim-vendime dhe dokumente tjera të nevojshme lidhur me zbatimin e politikave të ndryshme në interes të përgjithshëm të arsimit dhe kulturës, të njëjtat procedohen në Komitetin për Politikë dhe Financa.

1.1.4. Të dëgjoj apelet nga nxënësit në lidhje me kualitetin e mësimin dhe masave disiplinore,

1.1.5. Të propozoj dhe mbështes raportin shkollë-shoqëri në mes të shkollave dhe shoqërisë përreth me institucione publike dhe private të cilat merren me arsimimin e personave,

1.1.6. Të parashikoj dhe vlerësoj nevojat arsimore të komunitës në të ardhmen,

1.1.7. Të përcaktoj prioritetet globale për qytetin në sferën e arsimit dhe kulturës,

1.1.8. Të paraqes dhe rekomandoj për diskutim buxhetor ngjarjet e rregullta dhe të rëndësishme, festivalet e kampionatet.

## **Neni 10**

### **Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**

1. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale përbëhet nga 5 anëtarë që duhet të reflektoj në kuotën gjinore.

2. Kompetencat e këtij komiteti janë:

2.1. Të monitoroj implementimin e shërbimeve për kujdesin primar shëndetësor në Komunë.

2.2. Komiteti do të përfaqësohet në Këshillin Drejtues të QKMF-së në cilësinë e monitoruesit/vëzhguesit.

2.3. Shqyrton projekt-buxhetin për shëndetësi dhe jep propozime për Komitetin për Politikë dhe Financa.

2.4. Shqyrton planin vjetor të punës të përgatitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale.

2.5. Monitoron zbatimin e dispozitave në lidhje me rastet sociale, kategorive të dala nga lufta të UÇK-së, viktimave të dhunës në familje, fëmijë të mitur, të pastrehëve, të rikthyerëve dhe pensionistëve.

2.6. Të këshilloj dhe konsultohet me drejtorinë e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.

2.7. Të ndihmoj për caktimin e fondeve për strehim, në pajtim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

2.8. Të ndihmoj në formulimin e propozimeve për strategjinë e strehimit duke përfshirë mbulimin e qirave për të pastrehët dhe prioritetet përkatëse për renovime të ndërtimeve dhe ndihmën financiare.

2.9. Ndhmon në Mbikëqyrjen të situatës epidemiologjike në nivel komunal.

2.10. Ndhmon në monitorimin e masave mbrojtëse shëndetësore që kanë të bëjnë me sigurimin e ujit të pijshëm dhe aktiviteteve të DDD-së (Dezinfirmim, Deratezim, Dezinsektim).



## Neni 11

### Komiteti për Planifikim Urban, Mbrojtje të ambientit, shërbime publike dhe emergjencia

1. Komiteti përbëhet prej 5 anëtarëve, duke përfshirë edhe kuotën gjinore.
2. Kompetencat e këtij Komiteti janë:
  - 2.1. Të këshilloj dhe konsultohet me Drejtoritë respektive;
  - 2.2. Inicimi i programeve dhe projekteve komunale;
  - 2.3. Të përcjellë zbatimin e planit zhvillimor komunal (PZHK);
  - 2.4. Të përcjellë të gjitha çështjet lidhur me ndërtimin;
  - 2.4. Të kontrollojë procedurat për vendosjen e kiosqeve;
  - 2.5. Të kontrollojë procedurat për reklama;
  - 2.6. Të kontrollojë procedurat për zbatimin e planifikimit;
  - 2.7. Të ushtroj mbrojtjen dhe kontrollin e ndërtesave në interes arkitektonik apo historik;
  - 2.8. Të kontribuoj në aspektin profesional në ruajtjen e ambientit;
  - 2.9. Të kontribuoj në aspektin profesional në parandalimin e ndotjes së ambientit, ajrit, tokës dhe ujit;
  - 2.10. Të mbështes zhvillim e ardhshëm të komunës, sidomos në lidhje me mbrojtjen e tokës bujqësore;
  - 2.11. Shqyrton dhe propozon politika dhe dokumente tjera të nevojshme;
  - 2.12. Përmes bordeve të ndërmarrjeve komunale, monitoron dhe vlerëson efikasitetin e metodave dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve, përshtat nivelin e shërbimit dhe stafit.

## Neni 12

### Komiteti për Zhvillim ekonomik, bujqësi dhe zhvillim rural

1. Komiteti për Zhvillim ekonomik, bujqësi dhe zhvillim rural përbëhet prej 5 anëtarëve, duke përfshirë edhe kuotën gjinore.
  - 1.1. Kompetencat e këtij komiteti janë:
    - 1.2. Të këshilloj dhe të konsultohet me drejtoritë përkatëse.
    - 1.3. Të inicoj programet dhe projektet zhvillimore komunale.
    - 1.4. Përcjellë aktivitetet në fushën e zhvillimit ekonomik, të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

1.5. Kontribuon në krijimin e kushteve të qëndrueshme për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

1.6. Përgatitja e planeve konkrete për zhvillim e bujqësisë.

1.7. Merr pjesë në Projekt hartimin e planit për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të komunës.

1.8. Rekomandon plane konkrete për zhvillimin e ekonomisë.

1.9. Shqyrtimi i çështjes në lidhje me transportin publik.

### Neni 13

#### **Komiteti për barazi gjinore, të drejta të njeriut dhe komunitete**

1.1. Komiteti për barazi gjinore, të drejta të njeriut dhe komunitete përbëhet nga 5 anëtarë, duke përfshirë kuotën gjinore.

2. Kompetencat e këtij komiteti janë:

2.1. Mbikëqyr realizimin e të drejtave të barabarta, të drejtave civile, politike, ekonomike dhe kulturore të komuniteteve.

2.2. Krijimi i kushteve për kthim dhe integrim të qëndrueshëm të refugjatëve, të kthyerve, personave të zhvendosur dhe atyre të riatdhesuar.

2.3. Të mbikëqyr aktet, vendimet, në të cilat parashihet respektimi i kuotës gjinore.

2.4. Parandalimi i çfarëdo forme të diskriminimit të qytetarëve, që ndërlidhet me orientimin kombëtar, etnik, fetar, politik, racor, kulturor.

### Neni 14

#### **Formimi i Komisioneve nga Kuvendi, kompensimi i Komisioneve Kuvendare dhe Shërbimit Profesional (Sekretaria e Kuvendit)**

1. Kuvendi komunal formon komisione ad-hoc, si dhe komisione kuvendare tjera me qëllim dhe për nevoja të përmbushjes me sukses të objektivave të caktuara gjatë periudhave të caktuara.

2. Kuvendi komunal me rastin e formimit të komisionit gjegjës, çdo herë dhe në çdo vendim përcakton fushëveprimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe natyrën e punës së komisionit.

3. Komisionet kuvendare dhe sekretaria e kuvendit do të kompensohen për pjesëmarrjen në komisione si në vijim:

3.1. Çdo anëtarë i komisionit kuvendar si dhe anëtari i sekretarisë së kuvendit do të kompensohet në vlerën prej 50 eurove për çdo takim punues sipas vendimit të kuvendit.

3.2. Për çdo vendim të marrë nga Kuvendi Komunal, maksimum do të paguhen tri takime punuese të komisioneve respektive.

3.3. Kryesuesi i komisionit është përgjegjës për dorëzimin e procesverbaleve të takimeve të mbajtura në sekretarinë e kuvendit.

3.4. Sekretaria e Kuvendit obligohet të mbajë evidencën e saktë të takimeve të mbajtura për secilin komision të formuar nga kuvendi, dhe të njëjtat evidence në formën e shkruar duhet t'i procedojë për pagesa në departamentet gjegjëse.


### **Dispozitat kalimtare Neni 15**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje pushojnë të vlejshme dispozitat e Rregullores për punën e kuvendit dhe organeve të tij me Nr. 71/13 e datës 04.04.2013, sa i përket neneve që rregullojnë punën e komiteteve.

### **Neni 16 Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjete (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**

  
Kryesuese e Kuvendit



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government  
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

Për:	Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë Melihate Basholli Latifi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	<b>Datë:</b> 03.07.2023 Nr.-VI-0-490
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Ardita Latifi, Zyrtare e lartë për Monitorimin e Komunave	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim	
Lloji i aktit:	Rregullore	

I nderuar Kryetar,  
E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

<b>Rregulloren (KKV) NR.04/2023 për punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë</b>
E miratuar më datë: 31.05.2023
E parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07.06.2023

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, në aspektin procedural nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

#### Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur me datë 31.05.2023, ka miratuar Rregulloren (KKV) NR.04/2023 për punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë.

Rregullorja (KKV) NR.04/2023 për punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, përkatësisht Neri 4 pika 4 ku ndër të tjera thuhet se Kryesuesi i Komitetit do të jetë përgjegjës të sigurojë informatat mbi vlerësimin individual të kryerjes së punëve nga anëtarët dhe të paraqes raport për punën e komitetit së paku një herë në vit, është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, përkatësisht me nenin 10 pika 5 të *Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 05 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe komitetetve tjera në Komuna*, sepse në këto raste Komiteti nuk bën vlerësim individual, por e dorëzon raportin vjetor informues, më së largu deri në fund të muajit mars të çdo viti për vitin paraprak, ashtu siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kërkon që Komuna e Vushtrrisë, ta rishqyrtojë dhe harmonizojë aktin në fjalë, me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	188/23
Nr. i fq. / Br. st	-1-
Data: / Datum	28.07.2023
VUSHTRRI - VUÇITRN	



**Republika e Kosovës**

**Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 shkronja "d" të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 15 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi, nenin 19, paragrafi 1, pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më **27 korrik të vazhduar më 28 korrik 2023**, merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË VENDIMIT**

1. Me këtë vendim ndryshohet vendimi 01 Nr. 24/22 date.31.01.2022 për themelimin të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi si vijon :

- 1.1 Në paragrafin 1, pika 1.10, z.Zharko Mitroviç, Prift i Kishës ortodokse serbe, caktohet anëtar i KKSB-së
- 1.2 Në paragrafin 1, pika 1.14, z.Adem Hoti, Përfaqësues i komunitetit ashkali, caktohet anëtar i KKSB-së.
- 1.3 Në paragrafin 1, pika 1.15, z.Aziz Emini, Përfaqësues i Komunitetit rom, caktohet anëtar i KKSB-së.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e kryetarit dhe Sekretaria e Kuvendit.

3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Melihate Basholli-Latifi**



**Kryesuese e Kuvendit**



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 189/23

Nr. i fq. / Br. st -1-

Data: / Datum 28.07.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës-Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 "d" të Ligjit nr. 03/L-40/2008 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 4, 5, 6, dhe 21 pika 1.1 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, nenit 25 të Rregullores (QRK) për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Ligjin Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Planin Zhvillimor Komunal të Komunës së Vushtrrisë 2016-2024 dhe nenit 13 paragrafi 2 pika 1.4 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 27 të vazhduar me 28 korrik 2023, merr këtë:

### VENDIM

### PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë vendim jepet në shfrytëzim afatshkurtër për tri (3) vite, me mundësi vazhdimi, pas realizimit të investimeve, parcela kadastrale P-70202016-02358-7, në sipërfaqe prej 7380m<sup>2</sup>, ZK-Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë e evidentuar në emër të P.Sh. Shtëpi e Shëndetit, ashtu që përgjatë kësaj periudhe të realizohet investimi nga ana e Shërbimi Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, që lidhet me financimin e projektit për ndërtimin e parkingut nëntokësor dhe zgjerimi i hapësirave të shërbimit të emergjencës për nevoja të spitalit të Vushtrrisë në Komunën e Vushtrrisë.
2. Paluajtshmëria e cekur në pikën 1 të këtij vendimi i jepet në shfrytëzimin, Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës për nevoja të zgjerimin e hapësirave infrastrukturore të Spitalit "Sheikh Zayed" në Vushtrri.
3. Për pronën e cila jepet në shfrytëzim, Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës obligohet që të financoj projektin për ndërtimin e parkingut nëntokësor dhe zgjerimi i hapësirave të shërbimit të emergjencës për nevoja të spitalit të Vushtrrisë në Komunën e Vushtrrisë.
4. Në rast të ndërrimit eventual të lokacionit/zhvendosjes së spitalit në një lokacion tjetër gjatë periudhës kohore për të cilën i jepet në shfrytëzim, prona e paluajtshme e komunës e cila i jepet në shfrytëzim i rikthehet Komunës së Vushtrrisë në shfrytëzim.
5. Autorizohet Kryetari i Komunës që pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi të lidhë kontratë me përfaqësuesin MSH/SHSKUK për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale.
6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.
7. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është certifikata e pronës dhe kopja e planit.
8. Ky vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit



Republika e Kosovës  
 Republika e Kosovës - Republic of Kosovo  
 Qeveria e Kosovës - Government  
 Shërbimi Spitalor dhe Klinik i Universitetit të Kosovës - SHSKUK  
 Univerziteti i Kosovës - University of Kosovo - UBKSK  
 Hospital and University Clinical Service of Kosovo - HUCSK



REFERENCE:	/				
PËR/ZA/TO:	Kryesuesin/en e Kuvendit Komunal, Komunën e Vushtrrisë, Republika e Kosovës.				
Cc/Njofim:	Dr.Arben Vitia – Ministër, Ministria e Shëndetësisë, z.Ferit Idrizi – Kryetar, Komuna e Vushtrrisë.				
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Dr.Aida Rexhepi – Kryesuese, Bordi Drejtues SHSKUK.				
NGA/OD/FROM:	Dr.Narqize Arënliu-Hoxhaj – zv.Drejtor i Përgjithshëm, SHSKUK.				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për nevojat e Spitalit të Përgjithshëm “Sheikh Zayed” në Vushtri.				
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	10	Lokacioni: Kucni: Extension:	QKUK Objekti i Administratës Kati II	Data: Datum: Date:	27.02.2022
PËR AKTIVITET/ZÄ AKTIVNOST/FOR ACTION				x	
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION				x	

I/e nderuar,

Ndërlidhur me diskutimet që kemi zhvilluar për dhënien në shfrytëzim të pronës së komunës së Vushtrrisë me qëllimin që të zgjerohen hapsirat infrastrukturore spitalore të Spitalit të Përgjithshëm “SHEIKH ZAYED” në Vushtri, rrjedhimisht me qëllim të zgjerimit të gamës së ofrimit të shërbimeve shëndetësore për komunën tuaj, përmes kësaj letre distribuimi, kërkojmë nga Ju, që bazuar në Ligjin NR.06/L-092 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregulloren QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe Këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, të merrni vendim nga Kuvendi Komunal për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, për raste të veçanta nga Certifikata e pronësisë nr.p-70202016-02358-7 me sipërfaqe 7380 m2 me përshkrim 00-2004 me kohëzgjatje prej 99 vitesh për shkak të natyrës së investimit.

Për çdo sqarim shtesë ose informatë tjetër relevante, mund të na kontaktoni.

Bashkëngjitur gjeni certifikatën e pronës.

Me respekt,





Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës Univerziteteska Bolnička i Klinička Služba Kosova-  
Hospital and University Clinical Service of Kosovo  
Spitali i Përgjithshëm Sheikh Zayed- Vushtrri  
General Hospital Sheikh Zayed- Vushtrri

DATA:	20.12.2022
PËR/ZA/TO:	Dr. Pranvera Zejnullahu – Raci, U.d. drejtor i përgjithshëm i SHSKUK-së
NGA/OD/FROM:	Dr. Shefkije Shatri – Drejtor Ekzekutiv i Spitalit “Sheikh Zayed” <i>Shefkije Shatri</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kërkesë!
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION	<input checked="" type="checkbox"/>

E nderuara znj. Drejtoresh,

Si menaxhment i Spitalit “Sheikh Zayed” në Vushtrri siç ju kemi njoftuar verbalisht e kemi vlerësuar së bashku me donatorët nga Emiratet e Bashkuara Arabe, se objekti aktual i Spitalit nuk i përmbush nevojat për planifikimin tonë për shërbime të reja dhe për organizim të ri të punës. Duke e analizuar gjendjen dhe planin e punës kemi ardhur në përfundim se objekti aktual i QKMF-së në pajtim me mundësitë buxhetore të siguruar nga donatorët e Emirateve të Bashkuara Arave, duhet të rrënohet dhe të ndërtohet objekt i ri me lidhje fizike me objektin aktual të Spitalit. Në objektin e ri planifikojmë të organizojmë Emergjencën e Spitalit, Pediatrinë dhe Laboratorin, ku lidhja dhe qasja e automjeteve do të jetë shumë me e lehtë dhe më efikase. Po ashtu kemi planifikuar që në objektin e ri të barten të gjitha ambulancat specialistike si dhe administrata e Spitalit. Po ashtu në pjesën planifikuese është propozuar të ndërtohet parkingu nëntokësor ku do të ketë vend të mjaftueshëm për automjetet e punëtorëve të Spitalit. Me këtë organizim objekti aktual i Spitalit do të shërbejë vetëm për pacientet e hospitalizuar ndërsa pjesa e re e objektit do të organizojë gjithë veprimtarinë ditore të Spitalit.

Në këtë plan tonin është pajtuar edhe komuna e Vushtrrisë në parim si dhe donatori ku tani më kanë nisur matjet dhe planifikimet projektuese ku në bazë të tyre dhe kostos financiare do të vendosin se si do të veprojnë donatorët.

komunës për nisjen  
për të cilën...  
komunës për nevojat e Spitalit të  
dërgohet nga SHSKUK si mundim në cilën të drejtave dhe detyrime të koadë të institucioneve dytësore  
dhe të tjerëve të shëndetësia.

Me këtë rast ju lutem që në pajtim me shkresën tonë të cilën e kemi dorëzuar në Komunës të  
parashtroni kërkesë ju si drejtor i përgjithshëm i SHSKUK të Komuna e Vushtrisë për bashkëpunim e pronës së  
komunës për nevojat e Spitalit.

Të bashkangjitur ju lutem gjeni shkresën e dorëzuar nga ana jonë të kryetari i Komunës së Vushtrisë.

Me respekt!



Republika e Kosovës  
 Republic of Kosovo  
 Ministria e Shëndetësisë  
 Ministry of Health



Shtetërimi Spitalor dhe Klinikë Universitare Kosovës Univerzitetiska Bolnička i Klinička Služba Kosova-  
 Hospital and University Clinical Service of Kosovo  
 Spitali i Përgjithshëm Sheikh Zayed- Vushtrri  
 General Hospital Sheikh Zayed- Vushtrri

320/22  
 01.10.2022

PËR/ZA/TO:		Z. Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë			
NGA/OD/FROM:		Dr. Shefkije Shatri – Drejtor ekzekutiv i Spitalit Vushtrri			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Kërkesë			
Nr. i zyrës:		Lokacioni:	Drejtoria e Spitalit	Data:	31.10.2022
Br. kancelarije:		Kuçi:		Datum:	
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					
				x	

I nderuar z. Kryetar,

Fillimisht me lejoni të ju falënderoj në emër timin dhe të menaxhmentit të Spitalit për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm që kemi gjetur te ju. Si menaxhment i Spitalit jemi të përkushtuar të kemi bashkëpunim të vazhdueshëm me juve si Komunë për vet faktin se ju shërbejmë qytetarëve të njëjtit vend. Prandaj duke ju referuar qëllimeve të përbashkëta dhe nevojave që kanë qytetarët tonë më lejoni që në emër të institucionit që menaxhoj, Spitalit "Sheikh Zayed" në Vushtrri, të ju drejtohem me kërkesën si në vijim:

Spitali "Sheikh Zayed" në Vushtrri siç jeni të njoftuar ka të planifikuar 175 punëtorë të profileve të ndryshme specialistike, infermierike, administrative e teknike. Aktualisht kemi funksional repartin e Kirurgjisë, Gjinekologjisë, Maternitetit, Pediatriisë, Internos, Emergjencës, Radiologjisë, Labororit dhe ambulancat specialistike të reparteve të cekura. Përveç kësaj kemi ambulanta specialistike ditore për dermatovenerologji, liziatri, endokrinologji, urologji, kardiologji, gastroenterologji, pulmologji dhe reumatologji. Po ashtu kemi funksional edhe kabinetin e Kardiologjisë dhe Gastroenterologjisë. Krahas mjekësive specialistike mjekësore në të njëjtin objekt e kemi edhe administratën, sterilizimin, lavanderin, kuzhinën dhe shërbimet teknike. Duke ju referuar hapësirës që kemi, shërbimeve që ofrojmë dhe numrit të madh të pacientëve që marrin shërbime në Spitalin tonë, jemi të detyruar të mendojmë për zgjidhje alternative me qëllim të zgjerimit të hapësirës së Spitalit.

Në bisedat e përbashkëta jemi njoftuar për arritjet e sukseseve në kujdesin primar dhe zgjerimin e hapësirave shëndetësore duke ndërtuar edhe objektin e ri të mjekësisë familjare. Objekt që sipas njoftimeve përmbush nevojat për organizimin e mirëfilltë të një objekti shëndetësor si dhe planifikimin për bartjen e

Si përmendim në Spitalin e ri, kështu se objekti aktual i Spitalit - se që punën me mundësinë  
buxhetore të siguruar nga donatorët e kësaj lloji të Bashkuara Arabe, duhet të rrethohet dhe të ndërtohet  
objekti i ri me lidhje fizike me objektin aktual të Spitalit. Në objektin e ri planifikojmë të organizojmë  
Emergjencën e Spitalit, ku lidhja dhe qasja e automjeteve do të jetë shumë më e lehtë dhe më efektive. Po  
ashtu kemi planifikuar që në objektin e ri të barten të gjitha ambulancat specialiste në të cilat brenda ditës  
frekuentojnë objektin mbi 500 pacientë e shoqëruar gjithë që rrit rrezikun për bartje të infeksionit për pacientët  
e shtrirë dhe ata post-operativ. Po ashtu planifikohet të bartet edhe administrata e Spitalit, ku në të njëjtën  
hapësirë planifikohet të zgjerohet reparti i Pediatrikë për shkak të nevojave të mëdha dhe numrit të madh të  
pacientëve. Ndërsa në pjesën planifikuese të ndërtohet parkingu nëntokësor ku do të ketë vend të  
mjaftueshëm për automjetet e punëtorëve të Spitalit. Me këtë organizim objekti aktual i Spitalit do të  
shërbejë vetëm për pacientet e hospitalizuar ndërsa pjesa e re e objektit do të organizojë gjithë veprimtarinë  
ditore të Spitalit.

I nderuar z. Kryetar, jemi koshient për peshën e kërkesës dhe mbështetjen e madhe që po e kërkojmë  
nga ju dhe nga Kuvendi i Komunës por po aq jemi koshient se kjo do të jetë një ndër punët më të mëdha dhe  
më të mira që do të bëhen në Komunën tonë. Përfituesi më i madh dhe i pa kontestueshëm do të jetë qytetari,  
pacienti, për çka do të mbaheni mend gjithmonë për këtë punë aq të madhe që e keni mundësuar për ta.

Duke ju falënderuar për mbështetjen e deri tanishme, shpresojmë dhe besojmë se kjo kërkesën e jona  
do të gjejë mbështetjen tuaj!

Me respekt



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTRARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

18/1697

CERTIFIKATË / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTRARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202016-02358-7

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 18-1697/23

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vremen izdavanja / Date and time of submission: 12.07.2023 - 09:17

Komuna / Opština / Municipality: VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Vushtri / Vushtri / Vushtri


Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTRARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70202016-02358-7	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena / Inovina / Socially owned Land		7380	00-2004		

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTRARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place LOZJE	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
---	---	---	---	----------------------------------



## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shtfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area	(m <sup>2</sup> ) (m <sup>2</sup> ) (m <sup>2</sup> )
1	Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land	Oborr/Dvorište/Back Yard		5853	
2	Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land	Shtëpi:-Ndërtese/Kuca-Zgrada/House-Building		1527	

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Te drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosto adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Azurirano Updated
Poseidim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	P SH. SHËTËPI E SHËNDETIT	KCID0204928	VUSHTRRI / VUSHTRRI / VUSHTRRI /		"SITNICËS"	1/1	00-2004	






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VUSHTRRI  
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Vushtri

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Slpërfaqja/Povšina/Area m <sup>2</sup>
P-70202016-02358-12	Parcelë / Parcela / Parcel	41655



Shkalla/Razmera/Scale: 1:3355

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 12.07.2023

Koha/ Vreme/ Time: 09:20:46

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note: Mungon ndarja

Approvoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

